

V E N D I M
Nr.313, datë 12.5.2001

**PËR DHËNIE FOND NDIHME PARTISË “LËVIZJA MONARKISTE DEMOKRATE
SHQIPTARE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” dhe të ligjit 8718, datë 19.12.2000 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2001”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Partisë “Lëvizja monarkiste, demokrate, shqiptare” t’i jepet një fond prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh si ndihmë financiare në çastin e krijimit të saj.
 2. Ky fond të përballohet nga fondet buxhetore të vitit 2001 për partitë politike.
 3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta